

PROCES - VERBAL
Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objkti i Procedures: “Implementimi dhe Investimi ne nje zgjidhje softwarike te konsoliduar per menaxhimin dhe monitorimin e rrjetit elektrike”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
72263000-6 Shërbimet e Implementimit të Softwareve.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **100,000,000** (Njëqind milion) lekë pa TVSH.
- **999,100** (Nentëqind e nentëdhjetë e nente mijë e njëqind) euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ne piken 1 te nenit 6 te ligjit 16/2024, “per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ne VKM nr. 498, dt. 01.08.2024, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyesimit te meposhtem:

Objekt i kësaj procedure prokurimi është “Implementimi dhe investimi i nje zgjidhje software-ike të konsoliduar për menaxhimin dhe monitorimin e rrjetit elektrik”. Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) janë bërë mjete të domosdoshme në sektorin e menaxhimit të ndërmarrjeve energjetike. Duke integruar të dhënat hapësinore me infrastrukturën, klientët dhe informacionin operativ, GIS ofron një paraqitje gjithëpërfshirëse dhe vizuale të rrjetit të energjisë.

Per sa mesiper kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote pasi nuk mundet qe te permbushen qellimet sipas kerkesave te AK nese ka disa operatore, pasi do te krijohen problem ne koordinimin ne kohe reale per te dhene:

1. Vendimmarrja gjithëpërfshirëse.
2. Menaxhimi i përmirësuar i aseteve
3. Planifikimi efikas i rrjetit
4. Menaxhimi efektiv i ndërprerjeve
5. Menaxhimi i saktë i faturimit dhe i të ardhurave

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, në ligjin nr 16/2024 “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, për prokurimin publik”, në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, në nenin 11 të Vendimit nr. 498 datë 01.08.2024.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe marrë persiper çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100,000,000 (Njëqind milion) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “e hapur shërbime – mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që

operojnë ne treg si dhe per rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete minimalisht sa 100% e vleres se parashikuar te kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se:” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar.

Përkatesisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3 (tre) viteve te fundit 2021, 2022, 2023. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu te jene të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika” c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore “përcaktohet se:” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit

paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 35,000,000 (Tridhjetë e pesë milion) leke pa TVSH.

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.*

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshëm) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar personel të certifikuar që do të angazhohen në implementimin e projektit, stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate Perkatëse/Transkripte si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- a) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektësh ose ekuivalent ku të paktën 1 (një) me eksperiencë në menaxhim projektësh me teknologji GIS.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.
- c) Të paktën 1 (një) Analist të të dhënave gjeohapësinore me diplomë master në gjeoshkencat (gjeoinformatikë, gjeodezi, gjeografi ose ekuivalente) me minimum 3 vite përvojë pune.
- d) Të paktën 1 (një) të certifikuar për menaxhim baze të dhënash me minimumi 10 vjet eksperiencë ose ekuivalent.
- e) Të paktën 1 (një) Software inxhinier të certifikuar për zhvillim të aplikacioneve të cilat ka minimum 3 vite përvojë me zhvillimin e softuerit GIS ose ekuivalent.
- f) Të paktën 1 (një) ekspert të certifikuar për menaxhim të të dhënave në teknologji GIS ose ekuivalent.
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel CICP ose ekuivalent për Cyber security.
- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në teknologji ICS/SCADA ose ekuivalente.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

- a. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektesh ose ekuivalent ku te paktën 1(nje) me eksperience ne menaxhim projektesh me teknologji GIS.

Argumentim: Ky kriter garanton AK që operatori ekonomik ka në përbërje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet konform të gjitha kërkesave dhe afateve të përcaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti ku te paktën 1(nje) vit me eksperience ne menaxhim projektesh me teknologji GIS garanton organizimin e njerzve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit GIS. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent per sherbimet IT.

Argumenti: Per kriterin ne piken b) certifikimi për (ITIL) eshte një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit të suportit gjatë implementimit, në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të Autoritetit Kontraktor. Duke pasur një punonjës të certifikuar për ITIL, operatori ekonomik tregon përkushtim ndaj cilësisë dhe menaxhimit të shërbimeve IT në përputhje me standardet me te mira. Kjo ndihmon në sigurimin e një menaxhimi efektiv dhe të strukturuar të shërbimeve, duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e ofruar.

- c. Të paktën 1 (një) Analist të të dhënave gjeohapësinore me diplomë master në gjeoshkencat (gjeoinformatikë, gjeodezi, gjeografi ose ekuivalente) me minimum 3 vite përvojë pune.

Argumenti: Ky kriter garanton AK per aftesite profesionale per analizimin dhe perpunimin e te dhenave gjeohapësinore për objektin e kontrates, duke përdorur mjete dhe teknika të avancuara. Zhvilloni dhe menaxhoni bazat e të dhënave gjeohapësinore, duke siguruar integritetin dhe saktësinë e të dhënave. Krijoni dhe menaxhoni hartat tematike dhe raporte për analizat e të dhënave gjeohapësinore. Bashkëpunoni me ekipin për të zhvilluar dhe implementuar strategji për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave gjeohapësinore. Realizoni analizat statistikore dhe modele gjeohapësinore për të mbështetur vendimmarrjen dhe planifikimin.

- d. Te paktën 1 (nje) te certifikuar per menaxhim baze te dhenash me minimumi 10 vjet eksperience ose ekuivalent.

Argumenti: □ Nje ekspert I bzes se te dheanve me 10 vjet pervoje eshte thelbesore ne dizanjimin, optimizimin dhe mirembajtjen e bazave te te dhenave komplekse. Nje profesionit I tille sjell pervoje ne trajtimin e te dheanve ne shkalle te gjere, sigurimin e performances se larte dhe zbatimin e masave te sigurise. Pervoja eshte thelbesore per parashikimin e problemeve te mundshme, optimizimin e performances dhe sigurimin e integritetit te te dheanve ne te gjithe sistemin. Per me teper, ai duhet udheheq ne zgjedhjen e teknologjive me te pershtatshme te bazes se te dhenave per kete sistem te OSHEE duke I integruar ato pa problem me arkitekturen e software-it dhe duke shkallezuar infrastrukturen e bazes se te dhenave per te trajtuar ne menyre efikase vellimet ne rritje te te dhenave.

Planifikon, implementon dhe menaxhon strukturën dhe operacionet e bazave të dhënash në projektin GIS, duke siguruar performancën dhe integritetin e të dhënave. Projektton dhe

optimizon bazat e dhënash për aplikacione GIS, duke siguruar që ato të jenë të shkallëzueshme dhe të përshtatshme për nevojat e projektit.

Koordinon integrimin e të dhënave gjeohapësinore nga burime të ndryshme dhe sigurojeni që të dhënat të jenë të saktë dhe të përditësuara. Implementon dhe mbani politikat e sigurisë së të dhënave për të mbrojtur informacionin dhe për të parandaluar aksesin e paautorizuar. Përgatitni raporte dhe analizon të dhënat për të mbështetur vendimmarrjen dhe zhvillimin e strategjive të projektit GIS.

- e. Te paktën 1 (një) Software inxhinier te certifikuar per zhvillim te aplikacioneve i cili ka minimum 3 vite përvojë me zhvillimin e softuerit GIS ose ekuivalent.

Argumentim: *Kriteri garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE. Disponimi i 1 (një) Software inxhinier te certifikuar per zhvillim te aplikacioneve garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK lidhur me platformen GIS. Gjithashtu ky specialistë garantojnë vijueshmërinë normale të punës për gjatë gjithë periudhës së kontratës. Disponimi i 1 (një) programues/zhvillues software certifikuar për zhvillimin ose administrimin e bazës së të dhënave vjen si nevojë për të garantuar optimizimin, ndërhyrje të përgjegjshme në bazën e të dhënave si dhe për të garantuar performancë maksimale gjatë gjithë shtrirjes së kontratës pavarësisht shtimit të sasisë së të dhënave në të, pasi sistemi GIS është një sistem i cili përpunon miliona të dhëna të cilat rriten me miliona rekorde çdo muaj.*

- f. Te paktën 1 (një) ekspert te certifikuar per menaxhim te te dhenave ne teknologji GIS ose ekuivalent.

Argumenti: *Nje inxhinier i Menaxhimit te te Dhenave eshte thelbesore ne zbatimin e nje projekti software GIS per shkak te sasisë se te dhenave gjeohapësinore qe duhet te ruhen, organizohen dhe mirembahen me saktësi. Eksperti siguron integritetin, konsistencen dhe aksesueshmërinë e të dhënave, optimizimin rrjedhat e punës së të dhënave dhe zbaton praktikën e qeverisjes së të dhënave, duke i mundësuar projektit të trajtojë me efikasitet grupet komplekse të të dhënave. Ekspertiza mbështet integrimin pa probleme të burimeve të ndryshme të të dhënave, lehtëson ndarjen e të dhënave midis paleve të interesuara dhe siguron përputhjen me standartet e të dhënave, duke kontribuar perfundimisht në suksesin dhe shkallëzueshmërinë e projektit.*

- g. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ne nivel CICP ose ekuivalent per Cyber security.

Argumenti: *Per kriterin ne piken g) kërkesa për të pasur të paktën një punonjës të certifikuar për Cybersecurity është thelbësore për sigurinë dhe efikasitetin e sigurisë kibernetike, duke marrë parasysh natyrën sensitive të punës që kryen Autoriteti Kontraktor. Punonjësit e certifikuar për Cybersecurity kanë njohuri të thelluara në identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë, duke përfshirë sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga kërcënimet potenciale. Këta punonjës janë të aftë të analizojnë dhe zbatojnë masa të avancuara për të mbrojtur sistemet nga sulmet kibernetike, viruse, malware dhe çdo lloj rreziku tjetër që mund të kompromentojë integritetin dhe funksionalitetin e infrastrukturës dhe sistemeve që do të implementohen. Ata kanë përvojën dhe aftësitë e nevojshme për të zbatuar politika dhe protokolle të sigurisë që minimizojnë rreziqet dhe maksimizojnë mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve. Kërkesa për dy punonjës të certifikuar për Cybersecurity është hartuar në përputhje me specifikimet teknike të projektit, ku siguria kibernetike ka rol përcësor.*

- h. Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për siguri në teknologji ICS/SCADA ose ekuivalente.

Argumenti: *Ne një projekt të zbatimit GIS, nevoja për një Inxhinier Sigurie (SCADA) lind nga kërkesa kritike për të njohur Sistemet e Kontrollit Mbiqyres dhe Marrjes së të Dhenave (SCADA) që do të nevojiten gjatë dixhitalizimit në GIS për monitorimin dhe kontrollin në kohë reale të asetëve të infrastruktures. Ekspertiza është thelbësore për ruajtjen e integritetit të përgjithshëm dhe besueshmërisë së Infrastruktures GIS brenda projektit.*

- 2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe ISO 27001:2013 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme), ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente për menaxhimin e shërbimeve IT.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë

proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesit mbi to të jete i verifikueshem.

Theksojme se në të gjitha procedurat ku është vendosur si kërkesë që OE të disponojnë ISO 27001 nga ana e njesisë është përditësuar standarti duke kërkuar ISO 27001:2022 (pas konsultimit me faqen zyrtare të DPS), por nga ana e KPP-se nepërmjet me vendimin Nr. 376/2024 datë 18.04.2024 është arsytuar mbështetur edhe në përgjigjen që ka marrë nga DPA (citojme pjesë nga arsyetimi: Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 714/6 prot., datë 08.03.2024 “Kërkesë për 12 informacion” ju informojmë se certifikatat e lëshuara sipas ISO/IEC 27001:2013 nga OVK e akredituar nga DPA, për klientët e tyre, janë të vlefshme deri në datë 31.10.2025. Forumi Ndërkombëta i Akreditimit (IAF) ka vendosur një periudhë tranzitore 3 vite (36 muaj) për kalimin nga standardi ISO/IEC 27001:2013 në standardin ISO/IEC 27001:2022. Referuar dokumentit IAF MD 26:2022, versioni 1, periudha e tranzicionit për standardin ISO/IEC 27001:2022 do të vazhdojë deri në datë 31 tetor 2025) që iso ISO 27001:2013 është e vlefshme gjatë periudhës tranzitore deri në datë 31 tetor 2025.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorine e mbrojtjes kibernetike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej sistemeve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore që zgjerojnë ato ekzistuese dhe upgrade (përmirësim) të sistemeve ekzistuese sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet

e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Termat e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.